

# RAPORT VJETOR


2017





## Përmbajtja

|  | faqe           |
|--|----------------|
| 1. Të dhëna mbi tregun e sigurimeve 2017                 | 1              |
| 2. Rreth VIG   | 3              |
| 3. Rreth nesh  | 5              |
| 4. Momente Historike                                     | 7              |
| 5. Vizioni ynë   | 8              |
| 6. Sigma Interalkanian VIG në tregun e sigurimeve        | 9              |
| 7. Aksionerët, Këshilli Mbikqyrës dhe Bordi i Drejtorëve | 12             |
| 8. Organigrama   | 14             |
| 9. Përgjegjësia Sociale                                  | 15             |
| 10. Parimet e vlerësimit dhe monitorimit të rrezikut     | 21             |
| 11. Raporti i Auditit të brendshëm                       | 24             |
| 12. Raporti i Auditit të jashtëm.                        | <b>Aneks 1</b> |



Ku ndodhemi?

## Sigma Interalkanian në treg

9



## Përgjegjësia Sociale

15



## Të dhëna mbi tregun e sigurimeve 2017

Gjate vitit 2017 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 5.38%. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 826,038 mijë lekë duke arritur shifrën 16,193,678 mijë lekë. Gjatë vitit 2017 ka pësuar një zhvillim të ndjeshëm sigurimi i mjeteve lundruese dhe avionëve.

Në sigurimet vullnetare, rritjen më të madhe të tregut e ka ndikuar sigurimi nga Aksidentet personale, i cili është rritur me 25% ose me 108 milionë lekë më shumë se viti paraardhës. Rënie të ndjeshme ka pasur sigurimi i shëndetit i cili ka arkëtuar 65 milionë ALL më pak prime se viti i kaluar dhe sigurimi i përgjegjësisë me 46 milionë ALL më pak.

Tregu i sigurimeve të jojetës përbën 92.06% të totalit të tregut. Të ardhurat nga primet e jojetës shënuan një rritje me 4.21%. Tradicionalisht sigurimet motorike të detyrueshme kanë mbizotëruar në treg, ndaj edhe këtë vit të ardhurat nga ky portofol përbëjnë mbi 66% të gjithë tregut të jo-jetës. Numri i kontratave arriti në 1,261,238 duke shënuar një rritje me 11.99% krahasuar me vitin 2016.


Rritje e tregut të sigurimeve 5.38%

Rritje e sigurimeve te jo-jetes 4.21%


Janë paguar rreth 16% dëme më shumë se në 2016

Mbi 66% e primeve vijnë nga sigurimet motorike.

## Rritja e tregut në 2017



## Rritja e dëmeve në 2017



Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 14,907,715 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 4.21% krahasuar me vitin 2016.

Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 1,087,274 duke shënuar një rritje në masën 7.38% krahasuar me vitin 2016.

Gjatë vitit 2017, janë paguar gjithsej 5,514,171 mijë lekë dëme ose 15.80% më shumë se gjatë vitit 2016. Ndërkohë që numri i rasteve të miratuara për pagesë dëmi në tregun e jo jetës është rritur me 40%.

Numri i dëmeve të paguara në vitin 2017 është rritur me 12,538 dhe arriti shifrën 43,954 nga të cilat 42,390 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës.

Në raport me vitin e kaluar, Sigurimi nga Aksidentet ka paguar më shumë dëme, rreth 160% më shumë. Ndërsa në vlerë absolute, në sigurimet vullnetare, në portofolin e sigurimeve të shëndetit janë paguar 218 milionë ALL dëme më shumë se viti i kaluar. Gjithsesi, dëmet e paguara për sigurimet e detyrueshme motorike janë ato që përbëjnë pjesën më të madhe. 40% të totalit të dëmeve janë paguar për këtë portofol.



## Profili i Vienna Insurance Group

Ne fokusohemi që t'u ofrojmë klientëve në Austri dhe CEE me produktet të përshtatura për ta dhe shërbime të dizenuara sipas nevojave të tyre. Strategjia jonë është e orientuar drejt përfitueshmërisë së lartë dhe rritjes së qëndrueshme të fitimit, duke na bërë një partner të besueshëm në këto kohë vazhdimisht në ndryshim.

Mbi 25,000 punonjës punojnë për Vienna Insurance Group, në rreth 50 kompani në 25 vende të ndryshme. Ne zhvillojmë zgjidhje në sigurime duke iu përshtatur nevojave personale dhe lokale, të cilat na kanë bërë një prej liderëve në industrinë e sigurimeve në Austri dhe Evropën Qendrore dhe Lindore (CEE).

## Ekspertizë dhe Qëndrueshmëri

Vienna Insurance Group është një grup ndërkombëtar me selinë qendrore në kryeqytetin e Austrisë. Pas rënies së perdes së hekur në 1989, VIG u zgjerua shumë shpejt nga një biznes tërësisht austriak, në një grup ndërkombëtar. VIG është sinonim i qëndrueshmërisë dhe ekspertizës në aspektin e mbrojtjes financiare nga rreziqet. Origjina e grupit daton që në vitin 1824. Një eksperiencë prej gati dy shekujsh, e përfpcurar kjo me fokusin në kompetencën tonë në sigurime, formojnë një bazë të fortë dhe të sigurt për më shumë se 20 milionë klientë të grupit.

## Fokusi në Evropën Lindore dhe Qendrore

Përveç Austrisë, VIG është shumë e fokusuar edhe në Evropën lindore dhe qendrore si tregu i tij kryesor. Grupi gjeneron më shumë se gjysmën e të ardhurave të tyre nga primet në Evropën Lindore dhe Qendrore. Veprimet e VIG fokusohen gjithashtu në këtë rajon. Kjo reflekton kryesisht parashikimin për rritje ekonomike në CEE, e cila parashikohet të jetë dy herë më e lartë se në Evropën Perëndimore, si dhe nivelin aktual të dendësisë së sigurimeve, i cili është shumë më poshtë se ai i mesatares së Evropës.

## Prezencë në tregjet lokale

Për VIG, mbrojtja e klientëve financiarisht nga rreziku është një përgjegjësi. Grupi ndjek një strategji multi brand të bazuar në tregjet locale si dhe në menaxhimin lokal. Së fundmi, sukcesi i grupit dhe afërsia me klientin është baza e çdo brandi individual dhe know – how lokal.

## Financa të forta & Vlerësimi i kreditit

VIG ka një vlerësim A+ me një parashikim të qëndrueshëm, nga agjencia e mirënjohur e vlerësimeve, Standard & Poor's, që do të thotë që mbetet kompania e vlerësuar më mirë në indeksin e Bursës së Vienës, ATX. Vienna Insurance Group është e listuar jo vetëm në Vienë por edhe në Pragë. Wiener Städtische Versicherungsverein – një aksioner kryesor i qëndrueshëm me një fokus afatgjatë – ka rreth 70% të aksioneve të VIG. Aksionet e tjera tregtohen në bursë.

Rritje e tregut të sigurimeve 5.38%

Rritje e sigurimeve te jo-jetes 4.21%

Janë paguar rreth 16% dëme më shumë se në 2016

Mbi 66% e primeve vijnë nga sigurimet motorike.



# THE LEADING INSURANCE SPECIALIST IN AUSTRIA AND CEE.



**AUSTRIA**

**WIENER STÄDTISCHE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**onau**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**S-VERSICHERUNG**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**SLOVAKIA**

**Kooperativa**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**KOMUNÁLNA POISTOVNA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**POISTOVNA SLOVENSKEJ SPORITELNE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**BULGARIA**

**BULSTRAD**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Life BULSTRAD**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ESTONIA**

**COMPENSA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**TURKEY**

**RAYSIGORTA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ITALY BRANCH**

**WIENER STÄDTISCHE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**onau**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**POLAND**

**COMPENSA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**InterRisk**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**POLISA-ŻYCIE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**CROATIA**

**WIENER OSIGURANJE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ERSTE OSIGURANJE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**LATVIA**

**COMPENSA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Baltikums**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ETA**

**ALBANIA**

**SIGMA INTERALBANIAN**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**INTERSIG**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**SLOVENIA BRANCH**

**WIENER STÄDTISCHE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Vienna Life**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**HUNGARY**

**UNION BIZTOSÍTÓ**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ERSTE BIZTOSÍTÓ**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**viennalife**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**LITHUANIA**

**COMPENSA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**MACEDONIA**

**ОСИГУРУВАЊЕ МАКЕДОНИЈА**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**WINNER**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Life WINNER**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**CZECH REPUBLIC**

**Kooperativa**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ČPP**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**POJIŠŤOVNA ČESKÉ SPORITELNÝ**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**VIG Re**

**ROMANIA**

**OMNIASIG**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ASIROM**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**DE VIATA BCR ASIGURARI**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**SERBIA**

**WIENER STÄDTISCHE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**MOLDOVA**

**DONARIS**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**MONTENEGRO**

**Život WIENER STÄDTISCHE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**UKRAINE**

**КНЯЖА**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**life КНЯЖА**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ГЛОБУС**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**УКРАЇНСЬКА СТРАХОВА ГРУПА**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**BELARUS**

**КУПАЛА**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**BOSNIA HERZEGOVINA**

**WIENER OSIGURANJE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**GEORGIA**

**GPIA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**GERMANY**

**InterRisk**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**IRAQ**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**LIECHTENSTEIN**

**VIENNA-LIFE**  
VIENNA INSURANCE GROUP



## Rreth nesh

**Sigma Interalbani**an VIENNA INSURANCE GROUP u themelua në 1999 dhe regjistrua në Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr.20487 me datë 3 shkurt 1999. Aktiviteti i saj rregullohet nga nenet e Ligjit Nr. 9901 me datë 14 prill 2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligji Nr. 52 datë 22 maj 2014 "Për aktivitetet e sigurimit dhe risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", dhe aktet nënligjore të dala në funksion të tij.

Aktiviteti i saj kryesor është ofrimi i sigurimit për mjetet motorike, pronën, shëndetin dhe sigurime të tjera jo-jetë. Në 2004 gjithashtu –filloi aktivitetin e saj në Kosovë nëpërmjet degës së saj.

Shumë shpejt pas krijimit të saj, Sigma vendosi të zgjeronte aktivitetin edhe në rajon, duke hapur degët e saj përkatësisht në Maqedoni dhe Kosovë. Në këto tregje, falë përvojës dhe ekspertizës së stafit, arriti shumë shpejt të pozicionohet si kompani lider.

Në shtator të vitit 2007, Vienna Insurance Group vendosi të hyjë në tregun shqiptar, duke blerë aksione të kompanisë Sigma. Kjo kompani jo vetëm solli një frymë evropiane në tregun shqiptar, por ishte një emër që përcillte gjithashtu stabilitet dhe siguri për klientët.

Gjatë vitit 2014, Sigma dhe Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP sh.a. u bashkuan . Më 30 shtator 2014, emri i Shoqërisë u ndryshua nga "Sigma VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a në "Sigma Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a.

Ne jemi pararojë në sigurime, duke ofruar këshillim dhe produkte sigurimi për çdo biznes dhe individ, duke iu përshtatur nevojave dhe buxhetit të tyre. Ekipi ynë teknik është i aftë të ofrojë sigurime që i përshtaten çdo kërkesë dhe rrethane në vendin tonë. Njohuritë dhe eksperienca e stafit tonë, është një ndër pikat e forta të kompanisë.

Duke qënë se tregjet financiare janë gjithnjë në ndryshim, ne tregohemi të kujdesshëm që të trajnohemi vazhdimisht që t'i përshtatemi sa më mirë dhe në kohë këtyre ndryshimeve. Në stafin tonë kemi punonjës me njohuri teknike të shkëlqyera, por edhe ata me ekspertizën dhe njohuritë mbi ligjet dhe rregulloren në fuqi. Ky është një kombinim i shkëlqyer që na bën zgjedhjen e parë të klientëve që kërkojnë mbrojtje dhe siguri maksimale gjatë aktivitetit të tyre.

---

Kompania e parë private e sigurimeve

---

U themelua më 3 Shkurt 1999.

---

Në vitin 2002 filloi aktivitetin në Maqedoni dhe në 2004 në Kosovë.

---

Në vitin 2014 u bashkua me kompaninë Interalbani

---









Ku ndodhemi?





## Momente historike

|   |              |   |
|---|--------------|---|
|    | Shkurt 1999  | U themelua kompania e parë private në Shqipëri, SIGMA.  |
|    | Tetor 2002   | Sigma hyn në tregun maqedonas dhe filloi aktivitetin e saj në 2003.   |
|  | Shtator 2004 | Sigma liçensohet që të operojë në Kosovë, nëpërmjet degës së saj.   |
|  | Shtator 2007 | Sigma bëhet pjesë e Vienna Insurance Group  |
|  | Tetor 2014   | U bë bashkimi i kompanive Sigma dhe InterAlbanian dhe tani operojnë në treg me emrin Sigma InterAlbanian VIG  |
|  | Maj 2016     | Ndërrim gjeneratash në kompaninë Sigma InterAlbanian VIG. Z.Qemal Disha tërhiqet nga detyra si lideri historik i kësaj kompanie, për t'ia pasuar këtë detyrë, Z. Klaidi Çitozi. |



---

## MISIONI YNË

Ne jemi sinonim i stabilitetit dhe kompetencës përsa i përket mbrojtjes nga rreziku. Ne përdorim eksperiencën, njohuritë dhe diversitetin tonë për të qënë më pranë klientëve tanë. E konsiderojmë përgjegjësinë tonë që të mbrojmë ato që kanë vlerë për klientët tanë.

## VIZIONI YNË

Ne duam të jemi zgjedhja e parë për klientët tanë. Grupet e interesit na shohin si një partner të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Kjo bën të mundur që ne të forcojmë pozicionin tonë si kompani lider dhe zgjedhje e padiskutueshme për klientët.

## VLERAT TONA:

Diversiteti,

Mardhënia me klientin,

Përgjegjësia

## PREMTIMI YNË

Ne bëjmë të mundur që klientët tanë të jetojnë një jetë më të sigurt dhe më të mirë sepse ne: **Mbrojmë atë që ka vlerë për ju!**



## 5. Sigma Interalbanian VIG në treg

Viti 2017 ka qënë një vit pozitiv për kompaninë, e cila u rendit e treta në treg dhe të ardhurat nga primet shënuan një rritje prej 3%. Sigma Interalbanian zotëron mbi 14% të tregut të sigurimeve të Jo jetës.

Duke iu përmbajtur motos së saj prej vitesh, "Besimi juaj, detyrimi ynë", kompania paguan 18% të totalit të dëmeve të tregut, duke u renditur kështu e dyta në treg.

**Sigma interalbanian** synon gjithnjë e më tepër të rrisë prezencën e saj në treg nëpërmjet sigurimeve vullnetare. kështu rreth 28% e të ardhurave vijnë nga ky portofol.

Renditet kompania e tretë në treg për sigurimet KASKO me mbi 15% të tregut. Kompania e dytë në treg në sigurimin e TPL. Një rritje të konsiderueshme ka shënuar kompania edhe në sigurimet e pronës dhe shëndetit me afërsisht 20%, ndërkohë që rritja mesatare e tregut për këto portofole është përkatësisht 2.14% dhe 3.77%.

Falë ekspertizës së stafit, kompania është e gatshme të ofrojë edhe produkte me të cilat tregu ynë nuk është shumë familjar. Kjo e bën të dytën në treg për sigurimin e Përgjegjësisë Civile me 16% të tregut në këtë portofol.

---

Kompania e tretë në treg.

---

14% të tregut.

---


Paguan 18% të dëmeve.

---


Kompania e dytë në sigurimin e TPL dhe përgjegjësisë civile.

---


### Pjesa e tregut të Sigma Interalbanian VIG sipas Primeve të Shkruara




### Pjesa e tregut të Sigma Interalbanian VIG sipas Dëmeve të Paguara




### Ecuria e primeve të kompanisë në dhjetëvjeçarin e fundit



### Ecuria e dëmeve të kompanisë në dhjetëvjeçarin e fundit



## Sigma InterAlbanian VIG në shifra



gjatë vitit 2017, kemi lëshuar 144.000 polica

gjatë vitit 2017, kemi paguar 4.929 raste dëmsh

---

**AKSIONARËT****PËRQINDJA E  
AKSIONEVE**

|  |          |
|--|----------|
| Vienna Insurance Group AG Wiener Versicherung Gruppe | 89.053 % |
| Znj. Shpresa Prodani                                 | 4.487 %  |
| Z. Qemal Disha                                       | 3.735 %  |
| Znj. Shefikat Ngjela                                 | 1.232 %  |
| Z. Rasim Disha                                       | 0.747 %  |
| Z. Idajet Kuka                                       | 0.747 %  |

**BORDI MBIKËQYRËS I SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A**

Z. Peter Franz Hoefinger, Kryetar

Z. Christoph Rath, Anëtar

Znj. Sonja Raus, Anëtare

Znj. Shefikat Ngjela, Anëtare

Z. Jonard Prodani, Anëtar



## Bordi Drejtues

### **Z. Klaidi Çitozi – Drejtor i Përgjithshëm**

Z. Çitozi është pjesë e kompanisë prej 14 vitesh, tetë vjet nga të cilat si anëtar i bordit, dhe që prej vitit 2016 edhe si drejtues ekzekutiv i kësaj kompanie. Ai është aktuar i certifikuar dhe me përvojë të gjatë në fushën e marrjes në sigurim.

### **Z. Enid Minarolli – Zv. Drejtor i Përgjithshëm**


Z. Minarolli iu bashkua Sigma Interalbani si Anëtar i Bordit Menaxhues në vitin 2015. Përpara kësaj periudhe, ai ishte i angazhuar në Zyrat Qendrore të VIG në Austri.

### **Z. Ervin Rali - Anëtar Bordi**

Z. Rali ka një eksperiencë shumë të gjatë në sigurime, duke qënë dhe një ndër pionerët e kësaj industrie, veçanërisht në zhvillimet e teknologjisë që ka pasur tregu. Ai iu rikthye kompanisë Sigma Interalbani në vitin 2016 si Anëtar i Bordit të Drejtuesve të kompanisë, duke pasur në fokusin e tij veçanërisht shitjet dhe zhvillimet teknologjike.



# ORGANIGRAMA E KOMPANISË





## Sigma InterAlbanian VIG mbështet

### Mbështesim Artin - Viti filloi klas me Sigma InterAlbanian VIG

Viti 2017 u çel në mënyrën më klasike të mundshme për kompaninë tonë. Tigujt më të bukur të muzikës, magjia e koncertit të fillimvitit të Vjenës, për herë të parë u shijua dhe u prek live nga publiku shqiptar.

Violinisti Shkëlzen Doli dhe Ansambli i Filarmonisë së Vjenës erdhën me një koncert madhështor në Tiranë, një ngjarje e jashtëzakonshme artistike për kryeqytetin dhe artëdashësit shqiptarë. Koncerti u zhvillua në datën 2 janar në Pallatin e Kongreseve, një ditë pas koncertit të Filarmonisë së Vienës.

Kjo nismë artistike ka gjetur mbështetjen e autoriteteve më të larta të të dy vendeve, Shqipërisë dhe Austrisë, e që kryesohet nga Ministria e Kulturës së Shqipërisë si dhe partnerëve të tjerë publikë e private që i janë bashkuar këtij projekti, ndërmjet të cilëve edhe kompania Sigma InterAlbanian VIG.

Ky koncert do të shërbejë për rritjen e bashkëpunimit në botën e artit dhe kulturës por edhe të komunikimit ndërkombëtar, me një theks të veçantë për promovimin e Shqipërisë në rajon dhe më gjerë duke e kthyer vendin tonë në një qendër të re të performancës madhështore të Ansambllit Filarmonik të Vjenës.

Organizimi i kësaj ngjarjeje artistike të veçantë promovon më tej vendin tonë, duke rritur mundësitë për të krijuar një klimë më të mirë për investime dhe bashkëpunime të reja në fushën e artit e kulturës, por edhe të mjedisit ekonomik në vend.

Koncerti i Ansambllit të Filarmonisë së Vjenës ishte gjithashtu një frymëzim i fuqishëm për të gjithë artistët e rinj në Shqipëri, por edhe për ata që kanë një karrierë të suksesshme jashtë vendit, duke shërbyer si një thirrje për të kontribuar në jetën artistike të vendit të tyre.



## Mbështesim sportin – Sponsor të Federatës Shqiptare të Tenisit

Federata Shqiptare e Tenisit gjatë vitit 2017 ka pasur mbështetjen e kompanisë së Sigurimit, Sigma InterAlbanian VIG për zhvillimin e aktiviteteve të saj. Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua në Selinë Qendrore të kompanisë së sigurimeve, në praninë e drejtuesve të saj si dhe Federatës Shqiptare të Tenisit.

Drejtori i Përgjithshëm i Sigma InterAlbanian VIG, Klaidi Çitozi, u shpreh se “bizneset, përveç përfitueshmërisë, duhet të shikojnë dhe të kujdesen më shumë edhe për interesat e komunitetit. Tenisi, pavarësisht historikut të tij, konsiderohet si një sport relativisht i ri në Shqipëri dhe shumë pak i mbështetur financiarisht, ndaj ne e ndjejmë që ka nevojë të promovohet.

Dihet që sporti bashkon dhe inkurajon njerëzit për të ecur më tej, ç’ka ne urojmë edhe për Federatën Shqiptare të Tenisit që ajo të bashkojë njerëzit dhe të promovojë një stil jete të shëndetshëm. Ne e mbështesim tenisën pasi jemi të sigurt se qëllimi i këtij sporti, ashtu si dhe i kompanisë tonë, është që të kontribuojë për një të ardhme të mirë, më aktive dhe më të shëndetshme për brezat e rinj”.



Federata Shqiptare e Tenisit (FSHT) është krijuar në vitin 1993, por tenisi si sport në Shqipëri i ka fillimet e veta në vitet 1930. Aktualisht në Shqipëri zhvillohen 6 turne ndërkombëtare për moshat nën-14 vjeç, nën-16 vjeç dhe nën-18 vjeç, të cilët janë edhe në kalendarët zyrtarë të Tennis Europe dhe International Tennis Federation, si edhe disa turne kombëtare për të rinj, të rritur dhe seniorë (moshat mbi 35 vjeç) si dhe turne mini-tenisi për moshën nën 10 vjeç. Gjithashtu, përfaqësueset e FSHT-së marrin pjesë rregullisht në Kupën Davis, si edhe në disa turne ndërkombëtare në vendet fqinje me ekipet e grupmoshave U12 dhe U14.

## Mbështesim dijen - Prof. Asoc. Dr. Jordan Daci boton botimin e tretë të librit "Të drejtat e njeriut"


Ky botim i paraqitet lexuesit i përmirësuar, duke përfshirë shtimin e pjesëve të reja brenda kapitujve të mëparshëm, rritjen e numri të rasteve praktike të trajtuara, rritjen e peshës që zë trajtimi i problemeve të ndryshme të Drejtave të Njeriut në kuadër të Republikës së Shqipërisë (në vijim RSH) etj.

Në këtë kuadër, duhet theksuar që në vijim të botimit të tretë, trajtimi i çështjeve të ndryshme dhe ilustrimi i tyre me kuadrin ligjor Shqiptar, doktrinën dhe praktikën e gjykatave Shqiptare është rritur më tej, duke bërë kështu që libri të jetë akoma më shumë i lidhur dhe i konkretizuar me veçoritë që paraqet rasti i RSH.

Po ashtu, ky botim i ri i këtij libri pasqyron të përditësuarat të gjithë ndryshimet e ndodhura deri mars 2017 në kuadër të sistemit universal dhe sistemeve rajonale të mbrojtjes së Drejtave të Njeriut, duke përfshirë të dhënat statistikore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim GJEDNJ) në lidhje me RSH dhe të dhëna të tjera të rëndësishme.

Libri vazhdon të mbeten teksti bazë për lëndën "Të Drejtat e Njeriut" i disponueshëm në gjuhën Shqipe i cili paraqitet i plotë dhe me një metodologji dhe përmbajtje bashkëkohore në të njëjtat nivele me tekstet që përdoren në universitetet ndërkombëtare që trajtojnë plotësisht të gjithë problematikën e të Drejtave të Njeriut dhe përdoret si tekst bazë në të gjithë universitetet Shqiptare në RSH, në disa universitete në Maqedoni, në disa universitete në Kosovës dhe nga institucione të ndryshme duke përfshirë praktikantë dhe studiues të së drejtës brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Libri është konceptuar për të vazhduar të përdoret nga studentët të fakulteteve të drejtësisë, shkencave politike, të Shkollës së Magjistraturës si dhe praktikantë të së drejtës.



### **Mbështesim artin - Uwe Theimer dhe instrumentisti austriak Karl Bernhard në koncertin "Përshëndetje nga Austria"**

Me rastin e festimeve të ditës kombetare të Austrisë në Shqipëri, me mbështetjen e kompanisë Sigma Inter-albanian VIG dhe Ambasadës Austriake, në Tiranë u zhvillua koncertet "Përshëndetje nga Austria" nën drejtimin e dirigjentit të njohur austriak Uwe THEIMER si dhe klarinetistit Bernhard Karl. Koncertet u zhvilluan në bashkëpunim me Orkestrën e RTSH-së.

Gjatë këtij koncerti u luajtën pjesë të njohura nga kompozitorë të njohur si Schubert, Mozart dhe Strauss. Në këtë koncert nuk munguan dhe pjesët shqiptare. Marshi i Radetzkit dhe Danubi Blu ishin pjesët që përmbyllën këtë koncert me mjaft sukses.



### **Mbështesim shtresat në nevojë – Bashkëpunim me fondacionin "Fëmijët Shqiptarë"**

Fondacioni Fëmijët Shqiptarë është një organizëm jo qeveritar, jo fitimprurës dhe i pavaruar, i cili si mision ka krijimin e mundësive humanitare për një rritje më të shëndetshme të fëmijëve të sëmurë, atyre me nevoja të veçanta fizike e sociale, fëmijëve jetimë; të ndihmojë të moshuarit, familjet në nevojë dhe prindërit me shumë fëmijë, duke kontribuar për zgjidhje të qëndrueshme të problemeve të tyre në funksion të një të ardhme më të mirë.

Prej vitesh tashmë, Vienna Insurance Group si dhe kompania Sigma Inter-albanian VIG, ka zgjedhur të mbështesë terapinë e disa fëmijëve me nevoja të veçanta, familjet e të cilëve nuk e përballojnë dot këtë kosto aq të nevojshme për fëmijët e tyre.



FONDACIONI  
**FËMIJËT SHQIPTARË**  
DOMENICK SCAGLIONE



## **Mbështesim shtresat në nevojë – Fëmijët e policëve të rënë në detyrë**

Me rastin e festave të fundvitit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, organizoi një aktivitet festiv për fëmijët dhe familjarët e punonjësve të Policisë të rënë në krye e për shkak të detyrës.

Në fjalën e tij, ministri Xhafaj, theksoi: "Është në detyrimin tonë për t'ua bërë jetën juve shumë më të lehtë dhe në mënyrë të veçantë këtyre fëmijëve të mrekullueshëm, prindërit e të cilëve kanë bërë një akt sublim në jetë. Nuk janë sot këtu, pikërisht për të mbrojtur jetë, për t'i bërë jetët e të gjithëve dhe jo vetëm të fëmijëve të tyre shumë më të sigurt.

Nën atmosferën festive të krijuar nga donator të ndryshëm, u bë dhe shpërndarja e pakove me dhurata të ofruara nga kompani dhe organizata për familjarët dhe fëmijët e të rënëve të policisë në krye të detyrës. Edhe kompania Sigma Interlbanian shpërndau çeqe për 60 fëmijët që ishin present në këtë aktivitet.



## **Mbështesim fëmijët – Të njohim Shqipërinë**

Prej vitesh kompania Sigma Interlbanian VIG, mbështet ekskursionet e fundvitit të fëmijëve të një shkolle në një fshat në rrethin e Dibrës. Me dëshirën e madhe për të njohur më mirë historinë dhe gjeografinë e Shqipërisë, por edhe për të eksploruar vendet e bukura të saj, çdo fundviti shkollor, fëmijët e kësaj shkolle organizojnë një udhëtim në një vend të caktuar në Shqipëri.

Ky udhëtim është shumë i vlefshëm për këta fëmijë. Ata jo vetëm njihen me vise dhe kultura të reja, por njëkohësisht ju jep mundësinë dhe i nxit të mendojnë për kulturën dhe vendin e tyre. Edhe pse të vegjël, në kthim të këtyre udhëtimeve, ata gjejnë gjithnjë diçka për të përmirësuar në fshatin apo shtëpinë e tyre.



---

## **Mbështesim fëmijët – Ndhimohmë me institucionet arsimore të Tiranës**

Nismës së bashkisë së Tiranës, për të ndihmuar institucionet arsimore për paisjen e tyre me artikujt e nevojshëm, iu përgjigj dhe kompania Sigma InterAlbanian VIG.

Zgjedhëm një klasë në shkollën Petro Nini Luarasi, dhe duke konsideruar nevojën e tyre imediate për karrige, vendosëm t'i mbështesim ata. Gjatë kohës që ata qëndrojnë në klasë, është shumë e rëndësishme që nxënësit të ndihen komod, pasi kjo i ndihmon të përqëndrohen dhe rrjedhimisht të asimulojnë më lehtë mësimin.

Përveç kësaj shkolle, disa metra më tutje, ndodhej dhe kopshti shtetëror "Duarartët", i cili ishte i sapo rikonstruktuar por kishte ende paisjet e vjetra. Kompania vendosi që të rinovonte një pjesë të këtyre paisjeve, me premtimin që në të ardhmen do të rikthehej t'i mbështeste me donacione të tjera.

Kryetari i Bashkisë, Z. Erion Veliaj, dërgoi një letër për Drejtorin e Përgjithshëm të kompanisë, Z. Klaidi Çitozi, në të cilën e falenderonte për kontributin dhe theksonte ndikimin që këto donacione do të kishin në rritjen e brezave të rinj.



---

## **Parimi i vlerësimit dhe menaxhimit të riskut**

Procesi i vetevlerësimit të risqeve dhe aftësisë pagueze është një proces i brendshëm që shoqëria do të kryejë çdo vit për të vlerësuar përshtatshmërinë e menaxhimit të riskut dhe pozicionin e saj të tanishëm dhe të ardhshëm të aftësisë pagueze, në rastet normale të funksionimit dhe në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme (stress testing).

## **Struktura e Menaxhimit të Riskut të Shoqërisë**

Departamenti i Menaxhimit të Riskut është struktura përgjegjëse e monitorimit të riskut. Gjithashtu, struktura përfshin edhe një Komitet të Menaxhimit të Riskut, i miratuar nga Bordi i Drejtoreve.

## **Vetevlerësimi i Risqeve dhe Aftësisë Pagueze**

Procesi i vetevlerësimit të Risqeve dhe aftësisë pagueze të shoqërisë përbehet nga disa faza:

- i. Procesi i Kontrollit të Risqeve
  - a. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve
  - b. Vlerësimi kualitativ ose kuantitativ
  - c. Monitorimi, masat dhe kontrollet
  - d. Raportimi
- ii. Prova e Rezistencës
- iii. Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Pagueze
- iv. Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit dhe Testimi i Tij
- v. Profili i Përgjithshëm i Riskut

## **Procesi i Kontrollit të Risqeve**

Procesi i kontrollit të risqeve fillon me inventarizimin e tyre. Duke u bazuar në template të Vienna Insurance Group ("Shoqëria meme"), kemi bërë inventarizimin e risqeve kryesore të shoqërisë. Për çdo risk të identifikuar është bërë vlerësimi frekuence/shkalle e rëndësie, mënyrën që ata përdorin për vlerësimin e riskut dhe masat/kontrollet e ndermarra për secilin risk, nëse ka të tilla të nevojshme.



---

## 1. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve

Qellimi i procesit të Inventarizimit është identifikimi dhe kategorizimi i Risqeve.

Risqet kryesore të identifikuara ndërkombëtare janë:

- Risku i Tregut
- Risku i Marrjes në Sigurim së Jo-jetes
- Risku i Marrjes në Sigurim së Produktit të Shendetit
- Risku i Aktiveve të Patrupezuara
- Risku i Falimentimit të Pales Tjeter
- Risku i Likuiditetit
- Risku Operacional
  - Risku i nderprerjeve të aktivitetit
  - Risku i përqendrimit të njohurive
  - Risku i burimeve njëzore të pamjaftueshme
  - Risku i hardware dhe infrastruktures
  - Risku i software dhe i sigurisë
  - Risku i modelimit dhe kualitetit të të dhënave
  - Risku i zhvillimit të IT
  - Risku i projekteve
  - Risku i përputhshmërisë ligjore të lidhura me sigurimet
  - Risku i përputhshmërisë ligjore të tjera
  - Risku i proceseve dhe organizimit
  - Risku i gabimeve njëzore
- Risku Strategjik
- Risku i Reputacionit

### 2. Vlerësimi kualitativ ose kuantitativ

Në këtë proces bëhet vlerësimi i risqeve materiale. Vlerësimi bëhet në bazë të dy parametereve : frekuenca dhe shkalla e rëndësisë.

### 3. Monitorimi, masat dhe kontrollet

Monitorimi i të gjithë risqeve është i detyrueshëm dhe kryhet të paktën një herë në vit.

Në këtë proces monitorimi merr rëndësi vlerësimi i bërë i riskut dhe ndarja sipas shkallës së rrezikut.

### 4. Raportimi

Raportimi tek Bordi i shoqërisë përmban nivelet e risqeve dhe masat që duhen marrë për ato risqe të klasifikuara shqetësuese.





---

## **Prova e Rezistences**

Prova e rezistences eshte nje teknike e cila perdoret per te matur ndjeshmerine ndaj ngjarjeve qe kane nje probabilitet te vogel per te ndodhur, por qe kane nje efekt te konsiderueshem kur ato ndodhin. Dy metodat kryesore te ketij testimi jane analiza e ndjeshmerise dhe analiza e skenareve.

Faktoret makroekonomike kane nje efekt te madh ne kete lloj testimi. Risqet si ato te tregut, te kreditit apo operacionale jane drejtperdrejte te lidhur me luhatjet ne normat e interesave, cmimet e asetëve, dhe kursin e kembimit.

## **Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftesise Paguese**

Bazuar ne ligjin nr. 52/2014 date 22.05.2014, "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit", shoqeria duhet te mbaje nje fond garancie minimum ne shumen 370 milion leke (ose jo me pak se 1/3 e marzhit te aftesise paguese minimale).

## **Plani i Vazhdimesise se Aktivitetit dhe Testimi i Tij**

Plani i vazhdimesise se aktivitetit eshte formuluar dhe eshte perditesuar nga shoqeria per tju pershtatur ndryshimeve ne strukturen e shoqerise. Ne plan parashikohen hapat qe duhet te ndermerren ne rast te llojeve te ndryshme katastrofash, si dhe percaktohen personat pergjegjes per grupet e ndryshme te punes.

## **Profili i Pergjithshem i Riskut dhe Konkluzioni**

Duke konsideruar te gjithë analizen e mesiperme dhe gjetjet e rezultuara, arrijme ne perfundimin qe shoqeria ka nje nivel menaxhueshem te riskut ne teresi.



---

## Raporti i Auditit të Brendshëm

### *Permbledhje e aktiviteteve te Auditimit te Brendshëm për vitin 2017*

Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2017 në shoqërinë Sigma Interbalkanian VIG është kryer në përputhje me Planin vjetor të Auditit të Brendshëm të miratuar në Mbledhjen e Këshillit Mbikqyres të Grupit VIG dhe është bazuar në Kartën e Auditit të Brendshëm, në Manualin e Auditit të Brendshëm, në Parimet kryesore të Auditit të Brendshëm të Vienna Insurance Group dhe në Rregulloren Nr. 153 të AMF "Për veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në shoqërinë e sigurimit".

Gjatë vitit 2017 Departamenti i Auditit të Brendshëm ka audituar aktivitetet e shitjes dhe marrjes në sigurim, të administrimit, të risigurimeve, të menaxhimit të riskut, të trajtimit të detyrës, të menaxhimit financiar dhe të teknologjisë së informacionit, duke mbuluar kështu plotësisht të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë.

Aktivitetet e shitjes menaxhohen nga Departamenti i Shitjes në Drejtorinë e Përgjithshme dhe realizohen nga Degët e Shitjeve të cilat përmbajnë në strukturën e tyre agjentët e shitjes dhe ndërmjetesit e tjerë të shoqërisë Sigma Interbalkanian VIG.

Kontrollet e Auditit të Brendshëm për vitin 2017 në aktivitetet e shitjes janë fokusuar në zbatimin rregullores së shoqërisë, rregjistrimin e saktë dhe pa vonesa të policave në programin e shitjes, arketimin e primeve vecanerisht për produktet vullnetare, menaxhimin e llogarive të parandehnieve për shitjen, menaxhimin e komisioneve dhe bonuseve të shitjes, procedurat e marrjes së agjenteve të rinj dhe largimin e agjenteve egzistues, etj.

Kontrollet janë përqëndruar më së shumti tek risqet e mundshme që mund të vijnë si pasojë e gabimeve në rregjistrimet e policave të shitura në programin e shitjes, në saktësinë e të dhënave lidhur me kategorinë e automjetit, periudhën e sigurimit etj.

Departamenti i Administrimit është audituar gjatë vitit 2017 duke u fokusuar në problematikat e rakordimeve mujore të agjenteve të shitjes me degët dhe me drejtorinë e përgjithshme, në administrimin e primeve e paarketuara, në kontrollin e inventarizimit fizik të policave gjendje të furnizuara tek agjentët e shitjes, në zbatimin e procedurave për policat publikate dhe policat e anuluar, funksionimin e programit Edusoft për administrimin e policave dhe llogaritjen e komisioneve dhe bonuseve.



---

Aktivitetet e marrjes ne sigurim dhe menaxhimit te riskut kane funksionuar te harmonizuara me njera tjetren. Per cdo rast Komiteti i Menaxhimit te Riskut ka analizuar risqet e mundshme dhe ka miratuar marrjen ne sigurim dhe ofertat per percaktimin e primit ne perputhje me rregulloren e brendshme dhe urdhrat e Bordit te Drejtoreve te nxjerra per kete qellim.

Nga kontrollet ne Departamentin e Ri-sigurimeve ka rezultuar se veprimtaria e risigurimit ka funksionuar e bazuar ne Ligjin Nr. 52, date 22.05.2014, "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit", Rregulloren e Grupit VIG per Risigurimet dhe ne marreveshjet e lidhura ndermjet shoqerise dhe risiguresve perkates. Partneri kryesor per aktivitetin e risigurimeve eshte VIG-RE i cili eshte pjese e Vienna Insurance Group. Partneret e tjere jane perzgjedhur dhe miratuar bazuar ne rankimet nderkombetare te institucioneve nderkombetare per shoqerite e risigurimeve.

Kontrollet e auditit te brendshem kane konsistuar ne perpushmerine ligjore dhe te zbatimit te rregulloreve ne fuqi, njoftimin ne kohe dhe miratimin nga ana e Departamentit te Risigurimeve te Grupit VIG lidhur me risqet e mundshme dhe percaktimin e ofertave. Gjithashtu jane audituar raportimet periodike ne Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe ne Grupin VIG lidhur me objektet dhe kontratat e risigurimeve.

Veprimtaria e Departamentit Ligjor eshte e fokusuar ne perfaqesimin dhe mbrojtjen e shoqerise ne proceset gjyqesore me objekt trajtimin e demeve, pasurore dhe jo-pasurore, si dhe ato te fondit te kompensimit. Gjithashtu pjese e aktiviteve juridike te shoqerise jane primet e paarket-uara te klienteve dhe subjekteve debitore. Kontrollet e kryera nga Auditimi i Brendshem ne aktivitetet juridike te shoqerise gjate vitit 2017 jane fokusuar ne analizimin dhe percaktimin e risqeve qe vijne nga zgjidhja me proces gjyqesor e mosmarreveshjeve.

Funksionet e trajtimit te demeve, te administrimit financiar dhe te teknologjise se informacionit jane transferuar ne nje kompani sherbimi, VIG Services Shqiperi. Kriteret e ofrimit te sherbimeve te transferuara dhe treguesit e performances jane te percaktuara ne Marreveshjen e Nivelit te Sherbimit (SLA Agreement) ndermjet shoqerise Sigma Inter Albanian VIG dhe VIG Services Shqiperi. Kjo marreveshje eshte perdituesuar ne muajin Tetor 2017.

Auditimet e realizuara gjate vitit 2017 ne aktivitetet e trajtimit te demeve jane fokusuar ne zbatuesmerine e ligjeve ne fuqi, Rregulloreve te AMF dhe Rregulloreve te brendshme te miratuara nga shoqeria. Kontrollet e Auditit te Brendshem jane perqendruar ne menyre te vecante tek demet motorrike (Kasko dhe TPL) dhe tek demet e prones. Gjate auditimeve jane kontrolluar si databaza elektronike, rregjistrimet ne programin e demeve dhe dokumentat e skanuar elektronikisht, ashtu edhe ne dokumentacionin fizik te dosjeve te demeve.



---

# **Aneks 1**

## **Raporti i Auditit të Jashtëm**



**Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.**

**Pasqyrat Financiare  
më 31 dhjetor 2017 sipas  
Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar**

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Aksionerëve të Sigma Interallbanian Vienna Insurance Group sh.a

### Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të Sigma Interallbanian Vienna Insurance Group sh.a. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2017, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

#### Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017;
- pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

### Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

#### Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

### Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me drejtimin e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Objektivat tanë janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të disponojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe dokumentacionit shpjegues të bërë nga Drejtimi.
- Japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël mbi vijimin e aktivitetit të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vijuar aktivitetin. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimit të Shoqërisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

*PricewaterhouseCoopers Audit sh. p.k.*

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.  
15 maj 2018  
Tiranë, Shqipëri

Auditues Ligjor  
Jonid Lamllari

# Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group Sh.a.

## Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përvecse kur përcaktohet ndryshe)


|   | Shenime | 31 Dhjetor 2017  | 31 Dhjetor 2016  |
|---|---------|------------------|------------------|
| <b>AKTIVE</b>   |         |                  |                  |
| Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara | 10      | 329,455          | 333,089          |
| Aktive të mbajtura për investime                        | 11      | 107,189          | 112,066          |
| Aksione në shoqëri të lidhura                           | 12      | 11,404           | 10,063           |
| Aktive të risigurimit                                   | 13      | 1,887,169        | 1,724,888        |
| Kostot e shtyra të marrjes në sigurim                   | 16      | 341,895          | 324,673          |
| Llogari të arkëtueshme nga sigurimi e të tjera          | 17      | 330,964          | 224,390          |
| Aktive të tjera   | 18      | 170,614          | 200,478          |
| Aktive financiare të mbajtura deri në maturim           | 14      | 1,635,769        | 1,438,762        |
| Të arkëtueshme nga tatim fitimi                         | 19      | 11,839           | 35,265           |
| Depozita me afat me banka                               | 15      | 2,279,836        | 2,223,565        |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to                    | 19      | 224,113          | 222,696          |
| <b>TOTALI I AKTIVEVE</b>                                |         | <b>7,330,247</b> | <b>6,849,935</b> |
| <b>KAPITALI</b>   |         |                  |                  |
| Kapitali themeltar                                      | 20      | 498,213          | 498,213          |
| Rezerva e rrezikut të sigurimit                         | 21      | 171,792          | 171,792          |
| Rezerva e rivlerësimit                                  | 21      | 74,215           | 78,192           |
| Rezerva e rivlerësimit                                  |         | 26,659           | 39,082           |
| Rezerva e bashkimit                                     | 21      | 437,207          | 437,207          |
| Fitime/humbje të mbartura                               |         | 442,308          | 353,694          |
| <b>TOTALI I KAPITALIT</b>                               |         | <b>1,650,394</b> | <b>1,578,180</b> |
Vlera kontabël e një investimi rregullohet nga nxjerrja jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit të shitjes dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta vlen edhe nëse rezultati i nxjerrë jashtë përdorimit rezulton në një hap më poshtë nga filiali tek sipërmarrja e përbashkët ose një pjesëmarrja, matet me kosto.

**Marrëveshje të përbashkëta.** Sipas SNRF 11, investimet në marrëveshjet e përbashkëta klasifikohen si operacione të përbashkëta ose sipërmarrje të përbashkëta, në varësi të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të secilit investitor. Entiteti Raportues ka vlerësuar natyrën e marrëveshjes së saj të përbashkët me Intersig Vienna Insurance Group sh.a. në VIG Services sh.p.k. dhe i vendosi ata të jenë sipërmarrje të përbashkët. Sipërmarrjet e përbashkëta maten me kosto minus humbjen nga zhvlerësimi.

Në pasqyrat financiare të konsoliduara, sipërmarrjet e përbashkëta trajtohen duke përdorur metodën e kapitalit neto. Sipas metodës së kapitalit të kontabilitetit, interesat në sipërmarrjet e përbashkëta fillimisht njihen me kosto dhe përshtaten më pas për të njohur pjesën e Entitetit Raportues në fitimet ose humbjet e pas blerjes dhe lëvizjet në të ardhura të tjera përmbledhëse. Kur pjesa e humbjeve të kompanisë në një sipërmarrje të përbashkët është e barabartë ose tejkalon interesat e saj në sipërmarrjet e përbashkëta (që përfshin çdo interes afatgjatë që, në thelb, është pjesë e investimit neto të Kompanisë në sipërmarrjet e përbashkëta), Entiteti Raportues nuk njih humbje të mëtejshme, përveç nëse ka pasur detyrime ose ka bërë pagesa në emër të sipërmarrjeve të përbashkëta.

## **5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**Shitja e fillaleve, pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta.** Kur Entiteti Raportues pushon të ketë kontroll ose ndikim të rëndësishëm, çdo interes i ruajtur në njësinë ekonomike rimerr në vlerën e tij të drejtë në datën kur humbet kontrolli, me ndryshimin në vlerën kontabël neto të njohur në fitim ose humbje. Vlera e drejtë është vlera kontabël fillestare për qëllime të kontabilizimit të mëvonshëm të interesit të mbajtur si një pjesëmarrje, sipërmarrje e përbashkët ose aktiv financiar. Përveç kësaj, çdo shumë e njohur më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në lidhje me atë njësi ekonomike, llogaritet sikur Entiteti Raportues të kishte drejtpërdrejt në dispozicion aktivet ose detyrimet përkatëse. Kjo mund të thotë që shumat e njohura më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse janë riklasifikuar në fitim ose humbje. Nëse interesi i pronësisë në një pjesëmarrje zvogëlohet, por ndiqet një ndikim i rëndësishëm, vetëm një pjesë proporcionale e shumave të njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohen në fitim ose humbje kur është e përshtatshme.

### **(b) Monedha funksionale dhe e prezantimit**

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë njohur me kosto historike përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. :

- Aktivitet dhe detyrimet janë konvertuar me kursin e dates së mbylljes së periudhës kontabël;
- Të ardhurat dhe shpenzimet janë konvertuar me kursin mesatar të periudhës;
- Perberesit e kapitalit janë paraqitur të konvertuar me kursin historik; dhe
- të gjitha ndryshimet nga kursi i këmbimit janë njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Monedha operative e deges së Kompanisë është EUR. Në 31 Dhjetor 2017 kursi i këmbimit ishte EUR 1 = ALL 132.95 (2016: EUR 1 = ALL 135.23). Kursi mesatar i këmbimit ishte EUR 1 = ALL 134.13 (2016: EUR 1 = ALL 137.36).

### **(c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit**

Produktet e sigurimit të Entitetit Raportues klasifikohen në momentin e krijimit, për arsye kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi mbetet e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhen ose pushojnë së ekzistuari. Kontratat nën të cilat Entiteti Raportues pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguroese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të ardhshme të mundëshme në një ose më shumë norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese, indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiare kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

**Kontratat e përgjithshme të sigurimit** Detyrimet e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të vecantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e angazhimeve të ardhshme (të pafituar), rreziku i angazhimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e angazhimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (provizionet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Entiteti Raportues nuk i skanton detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar.

Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet me pasiguritë dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara. Entiteti Raportues ka përdorur kërkesat e legjislacionit shqiptar të sigurimeve për të përcaktuar detyrimet e sigurimit.

**Prime të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit** Primet e shkruara bruto përbëjnë shumat e detyruara gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma mund të perkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhë kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe nuk përfshijnë tatimet dhe detyrime doganore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëshmshpërlimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar

**Rezerva për primin e pafituar** Rezerva e primit të pafituar në të gjitha segmentet e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila vlerësohet të fitohet në vitin financiar pasardhës, duke përdorur metodën ditore në bazë proporcionale 1/365, e rregulluar nëse nevojitet në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Megjithatë, të gjitha produktet e Entitetit Raportues kanë rrezik linear dhe asnjë rregullim për ndryshime të rrezikut nuk është bërë.

## **5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

**Kostot e shtyra të marrjes në sigurim** Kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë pjesa e kostove të marrjes në sigurim të cilat zbriten gjatë llogaritjes së rezervës së primit të pafiturar.

Për të lidhur kostot e blerjes me të ardhurat përkatëse të primit, kostot e blerjes ndahen nga grupime sipas kontratave të sigurimit në përputhje me mënyrën e blerjes, shërbimit dhe matjes së rentabilitetit të kontratave të sigurimit të Entitetit Raportues. Kostot e blerjes të paamortizuara klasifikohen si një aktiv.

**Dëmet të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit** Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe duke provionuar dëmet e ndodhura por ende të paraportuara, efekti i ngjarjeve të parashikuara të brendëshme dhe të jashtëme, të tilla si ndryshimet e procedurave në trajtimin e dëmeve, inflacioni, tendencat juridike, ndryshimet legjislative dhe eksperiencat e mëparëshme. Provizioni për dëmet e papaguara nuk skontohej.

Rregullimet për provizionin e dëmeve të viteve të mëparëshme reflektohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale. Provizionet për pretendimet e ndodhura por të pa raportuara vlerësohen bazuar në metodën e trekëndëshave për produktet e përgjegjësishë së palës së tretë motorike ("MTPL") ndërsa për linjat e tjera të biznesit përdoret një metodologji e thjeshtuar e bazuar në raportin e Primeve të përfituara.

Nderkohë që Bordi i Drejtorëve konsideron se detyrimet e sigurimit për dëmet dhe marrjet nga risigurimi janë të drejta, detyrimi përfundimtar mund të ndryshojë si rrjedhojë e informacioneve dhe ngjarjeve të mëvonshme dhe mund të rezultojë në një rregullim të shumës së dhënë. Rregullimet për detyrimet e sigurimit reflektohen në pasqyrat financiare në periudhën në të cilën bëhet rregullimi

### **Angazhimet për dëmet në proces gjyqësor**

Një numër i konsiderueshëm i kërkesave për tu paguar janë në proces gjyqësor dhe për të cilën Entiteti Raportues ka njohur detyrimet përkatëse në bazë të vlerësimit të manaxhmentit (shënimi 30).

#### *(i) Risigurimet*

Entiteti Raportues cedon primet e siguruara dhe rrezikun në rrjedhën normale të biznesit me potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linjat e biznesit të MTPL, Pasurisë, Kartoni Jeshil, anije dhe avion, civile dhe përgjegjësi dhe linja të tjera biznesi.

Risigurime të tilla përfshijnë marrëveshjet për tejkalimin e humbjeve, marrëveshjet për ndarjen e kuotave dhe marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjese të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe atij kohor regjistrohen si aktive të sigurimit. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë nga detyrimet direkte ndaj policë-mbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të jashtëme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur u mbaron afati

Primet e risiguruara për risigurimin e ceduar njihen si shpenzim në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për sigurimin e përgjithshëm të biznesit, primet e risigurimit shpenzohen në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguarar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në aktivet e risiguruara. Shuma e njohur si aktiv i risiguarar matet në mënyrë që të jetë konsistente me matjet e provizionit të mbajtur në përputhje me kontratat e sigurimit

Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi përfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e ceduara risiguresit dhe të arkëtueshmet nga Shoqëria risigurese në përputhje me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të vecanta, nëse ka.

Aktivitet e risiguruara vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive, si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që Entiteti Raportues mund të mos marrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe ngjarja ka një impakt besueshmërisht të matshëm në shumat që Entiteti Raportues do të marrë.

#### *ii) Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve*

Në çdo datë raportimi Entiteti Raportues bën një test të mjaftueshmërisë të rezervave të dëmeve. Testet e para që realizohen janë Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analizën e Zhvillimit të provizioneve të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve realizohet çdo vit në mënyrë individuale për linjat kryesore të biznesit. Llogaritjet realizohen më vete për dëmet si dhe për dëmet që përfshijnë kostot e blerjeve si dhe kosto të tjera të jashtëme për trajtimin e dëmeve. Në realizimin e kësaj analize Entiteti Raportues merr në konsideratë vleresimet aktuale të fluksve monetare dalëse. Entiteti Raportues nuk i skonton këto fluksve monetare pasi pjesa më e madhe e dëmeve priten të zgjidhen brënda një viti.

## **5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

Për më tepër, Entiteti Raportues kryen çdo vit analizën e zhvillimit të provizioneve të dëmeve për të përcaktuar metodologjinë e rezervës. Kjo analizë kryhet në mënyrë të vecantë por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura por të paraportuara). Në rastet kur analiza paraqet parregullsi të theksuara, rregullime të caktuara i bëhen metodologjisë së rezervës.

Nëse një mungesë identifikohet ajo i alokohet fitimit ose humbjes duke krijuar një provizion për rrezikun e paskaduar nga humbjet që lindin nga testi i mjaftueshmerisë së detyrimeve.

### *iii) Portofoli i rezervës së primeve*

Kur një risigurues i ri merr pjesë në një marrëveshje me bazë vitin kontabël ose kur përfshirja në një periudhë, për një risigurues ekzistues rritet, ky funksion llogarit primin e pafitur marrë nga risiguruesi për pjesëmarrje në rreziqet për të cilat primi është mbledhur por nuk është fituar ende. Hyrja e portofolit të primit në fillim të periudhës së risigurimit është pjesa e përqindjes së risigurimit të primeve të pafituara në fillim të periudhës.

### **(d) Instrumentet financiare**

Instrumentet financiare të Entitetit Raportues maten me koston të amortizuar në varësi të kategorisë së matjes së tyre.

#### *i) Njohja*

Instrumentet financiare të Entitetit Raportues (aktivet dhe detyrimet) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të evidentohen nga transaksionet e tjera të tregut të tanishëm të vrojtueshëm në të njëjtin instrument ose me një teknikë vlerësimi, inputet e të cilave përfshijnë vetëm të dhënat nga tregjet e vëzhgueshme.

#### *ii) Klasifikimi*

Aktivet financiare kanë këto kategori: (a) hua dhe të arkëtueshme (depozita me afat me bankat dhe të arkëtueshmet e sigurimeve) dhe (b) aktivet financiare të mbajtura deri në maturim (HTM). Detyrimet financiare janë klasifikuar si detyrime të tjera financiare (përfshirë detyrimet e sigurimit / tregtisë dhe detyrimet e tjera) dhe janë përlogaritur kur pala tjetër kryen detyrimet e saj sipas kontratës dhe mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme** janë të kuotuar dhe aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të tjera përveç atyre që kompania synon të shesë në të ardhmen e afërt. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme përfshijnë **depozitat me afat me bankat dhe sigurimet dhe të arkëtueshmet tjera** dhe mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, neto e provizionit për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

#### *iii) Çrregjistrimi*

Entiteti Raportues çrregjistron një aktiv financiar nëse (a) humbet të drejtat kontraktuale mbi flukset e ardhshme të parasë ose (b) transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione ose ka hyre në transaksione përmes nderkohe që (i) është transferuar i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare ose (ii) as të transferon as të mbanë në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por pa mbajtur kontrollin. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësinë e saj për një palë të tretë të palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Shoqëria çrregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhen, anulohen ose maturohen.

#### *iv) Matja e koston se amortizuar*

Kosto e amortizuar e një aktivi apo detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ. Interesi i përlogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo primi ose zbritje deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e përlogaritura të interesit dhe shpenzimet e përlogaritura të interesit, duke përfshirë edhe kuponin e përlogaritura dhe zbritjen ose shpërblimin e përlogaritur (përfshirë tarifat e shtyra në fillim, nëse ka), nuk paraqiten vecmas dhe përfshihen në vlerat bartëse të zërave në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### *v) Netimi*

Aktivet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka për qëllim të arkëtojë ose të mbyllë aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara vetëm kur lejohet nga standartet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Entitetit Raportues.

## **5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **vi) Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura me koston e amortizuar**

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje kur ndodhin si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve ("ngjarja") që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit financiar dhe që kanë ndikim në shumën ose kohën e flukseve monetare të ardhshme të vlerësuar të aktivitetit financiar ose grupit të aktiveve financiare që mund të vlerësohen me besueshmëri. Nëse shoqëria konstaton se nuk ka dëshmi objektive se zhvlerësimi ka ndodhur për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm apo jo, ai përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe vlerëson kolektivisht ato për zhvlerësim. Faktorët kryesorë që shoqëria konsideron në përcaktimin nëse një aktiv financiar është zhvlerësuar janë statusi i saj i vonuar, detyrimet që mund të kompensohen për të njëjtin klient dhe realizueshmëria e kolateralit të lidhur, nëse ka.

Kriteret e tjera kryesore të mëposhtme përdoren gjithashtu për të përcaktuar nëse ka dëshmi objektive që ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi:

- çdo pjesë ose këst është vonuar dhe pagesa e vonuar nuk mund t'i atribuohet një vonese të shkaktuar nga sistemet e shlyerjes;
- pala përjeton një vështirësi të konsiderueshme financiare siç dëshmohet nga informacionet e saj financiare;
- pala tjetër është në faliment ose riorganizimin financiar;
- ka ndryshim negativ në statusin e pagesave të palës tjetër, si rezultat i ndryshimeve në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që ndikojnë palën; ose
- vlera e kolateralit, nëse ka, zvogëlohet ndjeshëm si rezultat i përkeqësimit të kushteve të tregut.

### **(e) Mjete monetare dhe ekuivalente me to dhe depozitat me afat**

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes. (d) Mjete monetare dhe ekuivalente me to mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Depozitat me afat me maturitet fillestar më shumë se tre muaj janë kalsifikuar si depozita me afat me bankat si kategori e huave dhe të arkëtueshme nga asetet financiare.

### **(f) Llogari të arkëtueshme nga sigurimi**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe më tej maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi dhe përfshijnë paratë e mbajtura nga agjentët. Të arkëtueshmet nga sigurimi vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi.

### **(g) Parapagimet**

Parapagimet mbahen me kosto minus provizionin për zhvlerësim dhe përfshihen në aktivet e tjera. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël të aktivitetit sapo Grupi ka marrë kontrollin e aktivitetit dhe është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me aktivin do të rrjedhin në Grup. Pagesat paraprake të tjera shlyhen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një indikacion se asetet, mallrat ose shërbimet që lidhen me një parapagim nuk do të pranohen, vlera bartëse e parapagimit shlyhet në përputhje me rrethanat dhe një humbje përkatëse e zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje për vitin.

### **(h) Garancia e kartonit jeshil**

Një nga linjat e biznesit të shoqërisë është sigurimi i kartonit jeshil. Aktualisht, Shqipëria është nën monitorimin e Byrosë Ndërkombëtare të Sigurimeve në lidhje me aftësitë e shoqërive të tregut të sigurimeve për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga sigurimi i kartonit jeshil.

Për këtë qëllim, Byroja Ndërkombëtare, i ka kërkuar Byrosë Shqiptare të Sigurimit të depozitojë një garanci në favor të saj e cila mund të shfrytëzohet në qoftë se një nga kompanitë e sigurimit shqiptare dështon në përmbushje detyrimet e sigurimit nga kartoni jeshil.

Shoqëria kontribuon në bazë të pjesës së saj të sigurimit në kartonin jeshil tek depozita e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve. Kontributi njihet nga Entiteti Raportues si një garanci në aktive të tjera, të cilat do të rimbursohen tek shoqëria sapo Zyra Ndërkombëtare të heqë kërkesën për depozitimin e garancisë.

## **5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **(i) Taksat**

Tatimet mbi të ardhurat janë parashikuar në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin e miratuar ose të nxjerrë në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese. Ngarkesa e tatimit mbi të ardhurat përbën tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në fitim ose humbje për vitin, përveç nëse ajo njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose në një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose direkt në kapital. Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet ose të rimburohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimet nëse pasqyrat financiare janë të autorizuara para se të dorëzojnë deklaratat përkatëse tatimore. Tatimet përveç të ardhurave regjistrohen tek shpenzimet operative.

Tatimi i shtyrë mbi të ardhurat është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimeve në bilanc për humbjen tatimore të mbartur dhe diferencat e përkohshme që dalin ndërmjet bazave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave të tyre bartëse për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një pasivi në një transaksion tjetër nga një kombinim biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon as në kontabilitet, as fitim të tatueshëm. Tatimi i shtyrë mbi të ardhurat është matur me normat tatimore të miratuara ose të vendosura substancialisht në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore përpara. Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore që barten në të ardhurat regjistrohen vetëm në masën që është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm të jetë në dispozicion kundrejt të cilit mund të përdoren zbritjet.

**Pozicionet e pasigurta tatimore** Pozicionet e pasigurta tatimore të Grupit rishqyrtohen nga menaxhmenti në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga menaxhmenti, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojë në vendosjen e taksave shtesë nëse pozicionet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose në thelb të miratuara deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo gjykatë e njohur ose vendime të tjera për çështje të drejtimit për shpenzimet e kërkuara për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Detyrimet për gjokat, interesat dhe taksat e tjera veçmas të ardhurat njihen në bazë të vlerësimit më të mirë të

**Tatimi mbi vlerën e shtuar** Tatimi mbi vlerën e shtuar që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore më e para se (a) mbledhja e të arkëtueshmeve nga klientët ose (b) shpërndarjen e mallrave apo shërbimeve për klientët. TVSH ne marrje është e recuperueshme kundrejt TVSH ne dalje pas pranimit të faturës. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja e lidhur me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e pozicionit financiar në baza bruto dhe shpaloset veçmas si një aktiv dhe pasiv. Kur është bërë provizioni për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

### **(j) Prona dhe pajisje**

#### **(i) Njohja dhe matja**

Ndertesat dhe pajisjet maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. (Shënimi 16). Kostoja përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me koston e blerjes së aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtaura vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse ka patur), çdo kosto tjetër drejtpërdrejt e atribuueshme që sjell aktivin në gjendjen e tij të parashikuar të punës, si dhe kostot e çmontimit dhe zhvendosjes së aktivitetit dhe rikthimit të vendndodhjes së tij në gjendjen e mëparshme. Kur pjesët e një aktivi kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato konsiderohen si elementë të veçantë (komponentë kryesorë) të pajisjes. Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një elementi të paisjeve përcaktohen përmes krahasimit të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pajisjes, dhe njihen neto brënda të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **(ii) Kosto te metejshme**

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritet që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për Entitetin Raportues dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të përhershëm të pajisjeve njihen në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve kur ato ndodhin.

## **5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **(iii) Zhvlerësimi**

Toka, parapagimet dhe aktivet në ndërtim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i ndërtesave dhe kategoria e përmirësimit në infrastrukturë realizohet përmes metodës lineare mbi jetëgjatësinë e vlerësuar të aktiveve, ndërsa zhvlerësimi i aktiveve të tjera përllogaritet mbi metodën e vlerësimit të mbetur.

Supozimet për vlerësimin e jetëgjatësisë të aktiveve të trupëzuara për periudhën aktuale dhe krahasuese është si vijon:

|  |         |
|--|---------|
| Ndërtesa dhe përmirësime të qiramarrjeve | 20 vjet |
| Mjete motorike                           | 5 vjet  |
| Kompjutera, Pajisje zyre dhe orëdi       | 5 vjet  |
| Kompjutera dhe programe kompjuterike     | 4 vjet  |

Vlera e mbetur, nëse jo e rëndësishme, rivlerësohet në mënyrë të përvitshme. Përmirësimet e qeramarrjeve kapitalizohen dhe zhvlerësohen për më të voglën midis jetës së dobishme dhe kohëzgjatjes së qerasë.

Metodat e zhvlerësimit dhe jeta e dobishme rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi.

### **(k) Aktive të patrupëzuara**

Aktivët e patrupëzuara përveç emrit të mirë kanë jetë të dobishme të përcaktuara dhe kryesisht përfshijnë softuere kompjuterik, patenta, markat tregtare dhe licenca. Licencat e softuerëve kompjuterikë, patentat dhe markat tregtare kapitalizohen në bazë të kostove të blerjes dhe për ti sjellë ato në përdorim.

Shpenzimet e zhvillimit që lidhen drejtpërdrejt me programet softuere të identifikueshme dhe unike të kontrolluara nga shoqëria regjistrohen si aktive të patrupëzuara nëse shtesat e flukseve të përfitimeve ekonomike tejkalojnë kostot janë të mundshme. Shpenzimet e kapitalizuara përfshijnë kostot e stafit të zhvillimit të softuerit dhe një pjesë të përshtatshme të shpenzimeve të përgjithshme. Të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me softuerin kompjuterik, p.sh. mirëmbajtjen e saj, regjistrohen si shpenzime kur ndodhin. Aktivët e patrupëzuara amortizohen duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së tyre të dobishme prej 7 vjetësh.

### **(l) Pronat e investuara**

Pronat e investuara janë prona të mbajtura nga Entiteti Raportues me qëllimin për të fituar të ardhura nga qiraja ose për rritjen e kapitalit, ose të dyja dhe të cilat nuk janë të zëna nga Entiteti Raportues. Pronat e investuara përfshijnë edhe aktivet në ndërtim e sipër të cilat do të përdoren në të ardhmen si prona të investuara. Pronat e investuara fillimisht njihet me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe më pas rimaten me vlerën e drejtë të përditësuar për të pasqyruar kushtet e tregut në fund të periudhës raportuese. Vlera e drejtë e pronës së investuar është çmimi që do të merret nga shitja e saj në një transaksion të rregullt, pa zbritur kostot e transaksionit. Treguesi më i mirë e vlerës së drejtë jepet nga çmimet aktuale në një treg aktiv për prona të ngjashme në të njëjtën vend dhe gjendje.

Në mungesë të çmimeve aktuale në një treg aktiv, Entiteti Raportues merr në konsideratë informacionin e gjeneruar nga burime të ndryshme si:

(a) çmimet aktuale në një treg aktiv për pronat e natyrës, kushteve ose vendndodhjeve të ndryshme, të rregulluara për të pasqyruar ato dallime;

(b) çmimet aktuale të pasurive të patundshme të ngjashme në tregje më pak aktive, të korrektuara në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet e kushteve ekonomike të ndodhura që nga koha e vendosjes së çmimeve; dhe

## **5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

(c) skontimi i projeksioneve të flukseve të parasë bazuar në vleresime të besueshme, të mbështetura në kushtet e qerave ekzistuese dhe kontratave të tjera (kur është e mundur) me evidencë të pavarur për tregun e qerave për pasuri të ngjashme në lokalitete dhe kushte të ngjashme, dhe duke përdorur norma skontimi që reflektojnë vleresimet aktuale për paqartësitë e flukseve të parasë dhe kohën e këtyre flukseve.

Vlera e tregut për investimet në pasuri të paluajtshme të Entitetit Raportues është vlerësuar nga ekspert i pavarur, i licensuar dhe me eksperiencë në vlerësimin e pasurive të ngjashme.

E ardhura nga qeratë është njohur në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve për vitin operacional si të ardhura të tjera operacionale. Ndryshimet në vlerën e tregut të investimit në pasuri të paluajtshme janë njohur në pasqyrën e të ardhura shpenzimeve për vitin operacional të ndara nga të ardhurat nga qeraja.

### **(m) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare**

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Entitetit Raportues, me përjashtim të aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperushme e aktivitetit, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aktiviteti me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi i njohur për një aktivitet në vitet e mëparshme kthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivitetit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

### **(n) Kapitali aksioner**

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje nga të ardhurat, neto nga tatimi. Çdo tejkallim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si pronë e aksioneve në kapitalin neto. Dividendët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe para se të mbyllet pasqyrat financiare, janë shprehur në shënimet e ngjarjeve pas periudhës.

### **(o) Rezerva e rrezikut të sigurimit**

Rezerva e rrezikut të sigurimit krijohet bazuar në Nenin 93 të Ligjit për Sigurimet dhe është e barabartë me një të tretën e fitimeve të periudhës së mëparshme nëse fitimet nuk përdoren për të mbuluar humbje të akumuluar të trashëguara prej viteve të mëparshme. Kjo rezervë nuk rritet më tepër se 30% e primeve mesatare të arkëtuara në dy vitet e fundit. Kjo rezervë krijohet për të garantuar aftësinë paguese dhe fondin e garancisë. Ajo nuk mund të përdoret nga Entiteti Raportues për ndonjë qëllim tjetër. Shoqëria nuk kërkohet të krijojë një rezervë ligjore si një kompani sigurimi e cila i nënshtrohet rezervës së rrezikut të sigurimit të përcaktuar me Aktin e Sigurimit.

### **(p) Njohja e të ardhurave**

#### *Primet*

Politikat kontabël në lidhje me të ardhurat nga kontratat e sigurimit janë sqaruar në shënimin 5(c).

#### *Të ardhurat nga interesat*

Të ardhurat nga interesi njihen në fitimin ose humbjen si të fituara, duke marrë parasysh interesin efektiv të aktivitetit. Të ardhurat nga dividendi njihen në fitim ose humbje në datën e deklarimit të dividendit.

#### *Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet*

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet përfshijnë komisionin e risigurimit, të njohur në marrëveshjen me risiguresit. Në përputhje me përjashtimin e lejuar nga SNRF 4, komisionet e risigurimit vazhdojnë të njihen plotësisht në marrëveshjen me risiguresin.

#### *Të ardhurat nga qiraja*

E ardhura nga qeraja njihet në bazë të të drejtave të konstatuara.



## **5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **(q) Kostot e blerjes se policave**

Shpenzimet e blerjes përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit, si dhe shpenzimet administrative të ndara lidhur me përpunimin dhe lëshimin e policave.

Kostot e blerjes së drejtpërdrejtë shtyhen gjatë afatit të policave në fuqi me një metodë në përputhje me llogaritjen e provizioneve të primeve të pafituara dhe paraqiten bruto nga detyrimet e lidhura të sigurimit si një aktiv. Shpenzimet e shtyra të blerjes amortizohen sistematikisht gjatë jetës së kontratës dhe testohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi. Çdo shumë që nuk kthehet regjistrohet si shpenzim.

### **Kostot e marrjes ne sigurim**

Shpenzimet e blerjes janë ato kosto që ndryshojnë dhe lidhen kryesisht me blerjen e kontratave të reja të sigurimit dhe rinovimit të tyre. Komisionet dhe shpenzimet e tjera (p.sh., pagat e punonjësve të përfshirë në funksionet e nënshkrimit të policave dhe tarifat mjekësore dhe inspektuese) që lidhen kryesisht me kontratat e sigurimit të lëshuara ose të përtëritura gjatë periudhës në të cilën koston lindin, konsiderohen shpenzimet e blerjes .

Shpenzimet e blerjes kapitalizohen dhe ngarkohen me shpenzime në proporcion me të ardhurat e pritura të njohura. Për të lidhur koston e blerjes me të ardhurat përkatëse të primit, koston e blerjes ndahen nga grupimet e kontratave të sigurimit në përputhje me mënyrën e blerjes, shërbimit dhe matjes së rentabilitetit të kontratave të sigurimit të Entitetit Raportues. Kostot e blerjes të paamortizuara klasifikohen si një aktiv.

### **(r) Kostot e trajtimit te demeve**

Kostot e trajtimit të dëmeve konsistojnë në shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve dhe nuk përfshijnë shpenzime të brendshme të mbulimit të dëmeve të cilat konsiderohen të jenë të parëndësishme krahasuar me koston e jashtme. Entiteti Raportues krijon provizione për koston e trajtimit të dëmeve.

### **(s) Shpenzimet**

#### *Shpenzimet operative*

Shpenzimet operative njihen kur ndodhin.

#### *Përfitimet e punonjësve*

Pagat, shpërblimet, kontributet në fondet shtetërore ose private, fondet e sigurimeve shoqërore, pushimet vjetore dhe pushimet mjekësore, shpërblimet dhe përfitimet jo monetare grumbullohen në vitin në të cilin shërbimet janë kryer. Entiteti Raportues nuk ka asnjë detyrim ligjor për të bërë pagesa të pensioneve ose përfitimëve të ngjashme përtej pagesave në skemën e kontributeve të përcaktuara statutore dhe private.

#### *Pagesat e qerasë operative*

Pagesat e bëra për qeratë operative njihen në pasqyrën humbje fitimeve me metodën lineare përgjatë kohëzgjatjes së qerasë.

### **(t) Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat e fondeve të investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kurset e këmbimit Të ardhurat nga interesat njihen në bazë të të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesave të huamarrjeve dhe humbjet nga kurset e këmbimit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit raportohen bruto.

## **5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)**

### **(u) Krahasueshmëria**

Për paraqitjen më të qëndrueshme të transaksioneve, klasifikimi i disa elementeve në informacionin krahasues financiar është ndryshuar për të qenë në përputhje me trajtimin e vitit aktual..

Ndryshimet e bëra nga Entiteti Raportues për shifrat krahasuese të pasqyrave financiare ,për shkak të gabimeve në vitet e mëparshme dhe ndikimi i tyre në kapitalin neto dhe bilancet e rivendosur në pasqyrën e pozicionit financiar dhe fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse janë paraqitur më poshtë.

i. Kompania ka njohur pjesën e risigurimit të rezervës së primit të pafitur (UPR) për MTPL për vitin e ardhshëm si "Aktivet e risigurimit" me një hyrje përkatëse në "Sigurime dhe detyrime të tjera" (si detyrim ndaj risiguruesit) për veprimtarinë e saj në Kosovë. Sidoqoftë, meqë marrëveshja e risigurimit të kuotës për MTPL mbulon vetëm periudhën vjetore prej 1 janarit deri më 31 dhjetor, nuk ka pjesë të papaguar të risigurimit në UPR të MTPL më 1 janar dhe 31 dhjetor 2016. Prandaj, kompania korrigjoi gabimin duke rregulluar "risigurimin e aktiveve "dhe" Sigurimet dhe detyrimet e tjera "me 139,730 mijë lekë më 1 janar 2016 dhe 140,976 mijë lekë më 31 dhjetor 2016.

ii. Kompania përfshiu "kapitalin themeltar" (detyrimet ndaj themeluesit) të degës së saj (veprimtarinë e saj të huaj në Kosovë) në kapitalin e vet, pasi që ishte kontribuar drejtpërdrejt nga aksionerët e saj për të plotësuar kërkesat e kapitalit të rregullatorit të sigurimeve në Kosovë. Sidoqoftë, kontributet e tilla nuk mund të jenë pjesë e kapitalit aksioner të kompanisë derisa aksioneri të vendosë për të kapitalizuar kontributet e bëra në kapitalin e kompanisë. Prandaj, kompania ka riklasifikuar shumën prej 197,050 mijë lekë nga kapitali aksionar në fitimet e pashpërdara.

iii. Shoqëria nuk ka njohur diferencat e këmbimit që rezultojnë nga paraqitja e rezultateve të operacioneve të saj të jashtme (nga EUR në Lek) në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse siç kërkohet nga SNK 21. Diferencat e tilla të këmbimit njiheshin drejtpërdrejt në kapitalin neto. Kompania korrigjoi këtë gabim duke postuar diferencat e këmbimit në të ardhura të tjera përmbledhëse.

Totali i kapitalit nuk ndikohet nga korrigjimet e mësipërme të gabimeve. Gabimi i përshkruar në paragrafin e mësipërm ka ndikuar vetëm në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse.



**Mbrojmë atë  
që ka vlerë për ju!**

**[www.sivig.al](http://www.sivig.al)**